

VENDIM
Nr.930, datë 2.7.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE TË QYTETIT, NË BASHKINË E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga zgjerimi i varrezave të qytetit, në bashkinë e Shkodrës, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e shpërblimit të pronarëve, për pasuritë, pronë private, me sipërfaqe 4 500 (katër mijë e pesëqind) m², tokë/arë, që shpronësohen, është 2 700 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë dhe të përballohet nga granti konkurrues, dhënë bashkisë së Shkodrës, për vitin 2007.

3. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit është tre muaj pas miratimit të këtij projekti.

4. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Shkodër dhe regjistrimi i ri i pasurisë prej 4 500 m² tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga bashkia e Shkodrës.

6. Afati i përfundimit të punimeve të objektit “Zgjerimi i varrezave publike të qytetit” të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia Shkodër.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONIT DHE PRONËN QË DO TË SHPRONËSOHET PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE TË QYTETIT NË BASHKINË SHKODËR

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr.pas.	Truall (m²)	Çmimi (lekë)	Vlefëta (lekë)
1.	Vat Nik Boshi	1965	256/26	490	600	294 000
2.	Gjovalin Rrok Vukelaj	1965	256/24	680	600	408 000
3.	Mark Mëhill Pjetri	1965	256/22	760	600	456 000
4.	Mëhill Kol Pjetri	1965	256/20	550	600	330 000
5.	Fran Kol Pjetri	1965	256/18	995	600	597 000
6.	Nazie Mehmetaj Kujtim Mehmetaj Arben Mehmetaj Shpëtim Mehmetaj	1965	256/16	1025	600	615 000
			Shuma	4500	Shuma	2 700 000